

Në bazë të nenit 18 të Ligjit për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10/20) dhe nenit 48-k të Statutit të Qytetit të Shkupit ("Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit 16/05, 8/10, 17/11, 18/13, 13/14, 1/15, 12/15, 4/19, 9/21 dhe 4/22), Kuvendi i të rinjve të Qytetit të Shkupit shpall:

## **THIRRJE PUBLIKE** **për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit lokal rinor të Qytetit të Shkupit**

### **1. Përshkrimi i shkurtër dhe kushtet e përgjithshme**

Me këtë Thirrje publike, ftohen të gjitha organizatat rinore, organizatat për të rinjtë, forumet rinore politike, organizata të nxënësve dhe studentore si dhe forma të tjera të shoqërimit rinor, të regjistruar në Regjistrin qendror me seli në Shkup, të emërojnë kandidatin/kandidatët e tyre të moshës nga 15 deri në 29 vjeçar në ditën e aplikimit, të cilët do të jenë anëtarë potencial të Këshillit rinor lokal të Qytetit të Shkupit.

Këshilli lokal rinor (KLR) i Qytetit të Shkupit, paraqet trup këshillëdhënës i Qytetit të Shkupit, të cilin e përbëjnë përfaqësues të rinj të formave të ndryshme të organizimit në Qytetin e Shkupit, i njëjti posedon rol këshillëdhënës dhe përfaqësues lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me interesin lokal në suaza të vetëqeverisjes lokale.

Këshilli lokal rinor posedon kryetarin dhe zëvendës kryetarin e tij, të cilët e përfaqësojnë Këshillin lokal rinor të Qytetit të Shkupit para Këshillit të Qytetit të Shkupit dhe të njëjtit janë të detyruar për mirëmbajtjen e komunikimit me nëpunësin për të rinjtë në Qytetin e Shkupit dhe seksionin për sport dhe të rinj pranë Sektorit për veprimtari publike të Qytetit të Shkupit.

### **1.1. Detyrat e Këshillit lokal rinor të Qytetit të Shkupit**

- Propozojnë pika të rendit të ditës për Këshillin e Qytetit të Shkupit, të cilat tangojnë të rinjtë;
- Iniciojnë çështje për rininë nga fushë veprimi i Qytetit të Shkupit;
- Iniciojnë, marrin pjesë dhe ofrojnë informacione kthyesë për procesin e strategjisë lokale rinore dhe për politikat tjera;
- Dorëzojnë informacione deri te Qyteti i Shkupit lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me të rinjtë dhe
- Kryejnë punë të tjera këshillëdhënëse dhe përfaqësuese në pajtim me Ligjin për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore.

### **2. E drejta e pjesëmarrjes në Këshillin rinor lokal të Qytetit të Shkupit**

**2.1.** Të drejtën e pjesëmarrjes në Këshillin rinor lokal të Qytetit të Shkupit e kanë të rinjtë e dominuar nga radhët e:

- Organizatave rinore;
- Organizatat për të rinjtë;
- Forumet rinore politike;
- Organizatat e nxënësve dhe të studentëve dhe

- Format tjera të shoqërimit rinorë.

**2.2.** Kandidatët e zgjedhur për anëtarë të Këshillit rinor lokal të Qytetit të Shkupit, detyrimisht duhet të jenë banorë në territorin e qytetit të Shkupit (Komuna e Aerodromit, Komuna e Butelit, Komuna e Gazi Babës, Komuna e Gjorçe Petrovit, Komuna e Karposhit, Komuna e Kisella Vodës, Komuna e Sarajit, Komuna Qendër, Komuna e Çairit, Komuna e Shuto Orizares) dhe të jenë të moshës nga 15 deri në 29 vjeçare.

### **3. Mënyra e paraqitjes de dokumentacioni i detyrueshëm**

Për paraqitjen në Thirrjen publike, parashtruesit janë të detyruar që të dorëzojnë dokumentacionin vijues:

- Fletëparaqitjen e plotësuar (fletëparaqitja do të shpallet në ueb faqen e Qytetit të Shkupit: [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk));
- Portofoli i kandidatit, (dokument jo më i gjatë se dy faqe në të cilin do të përfshihen informacionet e përgjithshme lidhur me punën, vizionin dhe misionin, aktivitetet kryesore, informacionet për personin, informacionet për kontakte dhe adresa, telefoni për kontakte, ueb faqja dhe etj.);
- Raporti i aktiviteteve me të rinjtë gjatë vitit të kaluar të kandidatit për anëtarë të Këshillit rinor lokal të Qytetit të Shkupit;
- Letër motivimi për anëtarin i cili pretendon që të bëhet pjesë e Këshillit rinor lokal të Qytetit të Shkupit si dhe shkaqet për të cilët kandidohet dhe
- Dëshmi se kandidatët e nominuar për anëtarë të Këshillit rinor lokal të Qytetit të Shkupit janë banorë të Qytetit të Shkupit dhe se janë të moshës nga 15 deri në 29 vjeçare.

### **4. Mënyra e realizimit të thirrjes publike**

Për Këshillin rinor lokal të Qytetit të Shkupit zgjidhen 9 (nëntë) anëtarë.

Vendimi për formimin e Këshillit rinor lokal të Qytetit të Shkupit e miraton Këshilli i Qytetit të Shkupit në propozim të “Komisionit për verifikim, çështje të mandateve, mirënjohje, parashtrësia dhe ankesa” pranë Këshillit të Qytetit të Shkupit, pas vendimit të pranuar më parë për zgjedhjen e anëtarëve sipas parimit të përfaqësimit gjinorë nga ana e Kuvendit rinor të Qytetit të Shkupit.

Anëtarët e Këshillit rinor lokal të Qytetit të Shkupit, zgjidhen me mandatin prej 2 viteve me të drejtën e zgjedhjes së sërishme.

### **5. Afati dhe mënyra e dorëzimit të fletë paraqitjeve**

Thirrja publike shpallet në ueb faqen e Qytetit të Shkupit ([www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk)), në mediumet e shtypit (edhe atë në së paku një gazetë ditore në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën që flasin së paku 20 % e qytetarëve që flasin gjuhën zyrtare që dallohet nga gjuha maqedonase) dhe në mediumet elektronike.

Thirrja publike do të shpallet më datën 30.08.2023 dhe do të zgjas 14 ditë të kalendarit, më vonë deri më datën 12.09.2023 deri në ora **15:00**.

Dokumentacionin e nevojshëm, parashtruesit e parashtrojnë në zarf të mbyllur deri te Komisioni përmes Arkivit të Qytetit të Shkupit, ose përmes postës në adresën: Bulevardi “Ilinden” nr. 82, 1000 Shkup, me shenjën: “Deri te Sektori për veprimtari publike – Kuvendi rinor i Qytetit të Shkupit – Komisioni për formim të Këshillit rinor lokal të Qytetit të Shkupit”.

Zarfi nuk duhet të përmbaj kurrfarë shënimi që do të identifikoj kandidatin.

Fletëparaqitja me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet në një ekzemplarë origjinal, të plotësuar në trajtë elektronike, të nënshkruar dhe verifikuar / vulosur nga ana e personit përgjegjës të parashtruesit.

Fletë aplikimet e plotësuara në mënyrë manuale fare nuk do të shqyrtohen.

Fletë aplikimit e dorëzuara me vonesë, Komisioni nuk do ti shqyrtojë.

***Për informacione plotësuese:***

Informacione plotësuese mund të merren në Sektorin për veprimtari publike – seksioni për sport dhe të rinj, në numrin e telefonit: 3297-320.

Për më shumë informacione lidhur me këshillat rinore mund ti lexoni dokumentet vijuese:

1. Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore, që mund të merret në: <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/862649465cf4432aadcb4119f52bfd81.pdf>
2. Doracaku për këshillat rinore lokale, që mund të merret në: <https://www.osce.org/mk/mission-to-skopje/491135>

**QYTETI I SHKUPIT  
KUVENDI RINOR I  
QYTETIT TË SHKUPIT**